



Prishtinë: 03.10.2016
Kodi i ZRRE-së: V_846_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

1. Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, neni 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
2. Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1516/2011 i datës 02.03.2016;
4. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Kosovë Departamenti për Çështje Administrative, A.A.nr.145/2016 i datës 11.08.2016.

me datë 03.10.2016, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I **APROVOHET pjesërisht** ankesa e konsumatorit A. K. "M.M.", nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.
- II **Obligohet** KESCO që të shkarkojë konsumatorin A. K. "M.M." nga korrigjimi nr.28538 të datës 27.08.2010 në vlerë financiare prej 33,769.81€.

Arsyetim

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) me datë 22.12.2011 ka ushtruar padi për anulimin e vendimit të Bordit të ZRRE nr. V_381_2011 të datës 28.10.2011.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative me datë 15.09.2014 ka marrë Aktvendim me të cilën ka detyruar të paditurën Zyrën e Rregullatorit për Energji që brenda afatit prej 30 ditësh t'i siguroj të gjitha shkresat e lëndës dhe t'i paraqes gjykatës prapësimet procedurale përmes përgjigjes në padi.

Zyra e Rregullatorit për Energji bazuar në aktvendimin e gjykatës së lartpërmendur me datë 22.10.2014 ka parashtrua përgjigje ndaj padisë së ushtruar nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) duke i ofruar gjykatës të gjitha argumentet se vendimi Bordit të ZRRE-së është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative me datë 02.03.2016 ka mbajtur shqyrtimin kryesor me ç'rast ka dëgjuar argumentet e palëve në kontest dhe pas analizimit të të gjitha provave, me datë 02.03.2016 ka marrë Aktgjykim A.nr.1516/2011 me ç'rast ka Aprovuar kërkesë padinë e paditësit KEK, ndërsa ka anuluar vendimin e Bordit të ZRRE-së duke e kthyer të njëjtin në rishqyrtim dhe rivendosje.



ZRRE duke mos u pajtuar me Aktgjykimin e gjykatës shkallës së parë A.nr.1516/2011, me datë 14.04.2016 ka ushtruar ankesë përmes kësaj gjykate në Gjykatën e Apelit në Kosovë, Departamenti për Çështje Administrative për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata e Apelit në Kosovë, Departamenti për Çështje Administrative pas shqyrtimit të ankesës së ZRRE-së me datë 11.08.2016 ka marrë Aktgjykim duke refuzuar si të pabazuar ankesën e ZRRE dhe ka Vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1516/2011 i datës 02.03.2016.

Sipas Aktgjykimit të shkallës së parë i vërtetuar edhe nga shkalla e dytë, ZRRE obligohet që vendimin e Bordit ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje, pasi i njëjti konsiderohet se ka të meta të në përputhje me dispozitat e nenit 84, paragrafi 2, si dhe nenit 85 të Ligjit për Procedurën Administrative. Gjykata ka evidentuar vërejtjet sa i përket dispozitivit të vendimit me arsyetimin se nuk është e qartë se cila pjesë e ankesës është refuzuar.

Meqenëse aktgjykimet e theksuara më lartë e obligojnë Bordin e ZRRE-së që të rishqyrtojnë edhe njëherë vendimin e atakuar dhe të njëjtin ta hartojnë në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 84 paragrafi 2 dhe neni 85 të Ligjit për Procedurën Administrative, Bordi i ZRRE-së me qëllim të zbatimit të këtyre aktgjykimeve, do ti dëshmoj gjykatës se vendimi i Bordit është bazuar në prova konkrete dhe i mbështetur në rregulla dhe ligje.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 03.10.2016 ka konstatuar se varësisht nga rrethanat e krijuara rreth anulimit të vendimit, mbetet edhe më tutje pranë pretendimeve të theksuara si në vendimin e atakuar, pasi që konsideron se KEK nuk ka aplikuar saktë dispozitat ligjore me rastin e vendosjes së kësaj çështje, për faktin se veprimet e ndërmarra nga ana e saj janë kontradiktore, ku fillimisht një komision brenda KEK-ut me datë 19.02.2010 e ka ngarkuar konsumatorin me vlerë financiare prej 6,136.91€ (shfrytëzim i paautorizuar), e më pas një komision tjetër i KEK-ut në kundërshtim me nenin 32, paragrafi 1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, e duke mos i besuar komisionit të parë të kësaj ndërmarrje e ka ngarkuar konsumatorin edhe me një ngarkesë shtesë prej 33,769.81€, me ç'rast e ka dëmtuar konsumatorin pa bazë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Bordi i ZRRE-së gjatë shqyrtimit të ankesës së konsumatorit ka konstatuar se KEK-u me rastin e ngarkesave për shfrytëzim të paautorizuar nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore të nenit 32 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, pasi e njëjta e ka ngarkuar konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike edhe përkundër që vet punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 17.03.2009 në procesverbalin inspektimit nr.1369 kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 30662159 bënë regjistrimin e energjisë elektrike në mënyrë të rregullt.

Bordi i ZRRE-së gjithashtu me rastin e shqyrtimit të ankesës së konsumatorit ka marrë për bazë edhe dispozitat e nenit 4.9.4 të Kodit të Matjes (kodi i matjes) ku theksohet se ndërmarrja e energjisë (Operatori i Sistemit të Shpërndarje- KEK) duhet së paku 1 (një) herë në vit ose kur të merret ankesa të bëjë testimin e sistemit matës dhe të njehsorit elektrik, por që te rasti i konsumatorit KEK-u nuk ka bërë testim të sistemit matës. Po ashtu sipas neni 5.8.6 të Kodit të Matjes theksohet se Qendra e kontrollit të OSSH duhet të kontrolloj raportin e herësit të TMRR çdo vit ose atëherë kur kërkohet rritje e kërkesës nga ana e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së gjatë shqyrtimit të lëndës së konsumatorit është bazuar edhe nenin 54 të Ligjit për Energjinë Elektrike, ku theksohet se pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë.



Si argumente shitesë dhe të bazuara, ZRRE ka marrë për bazë edhe listat e leximit, për periudhat 06/2009 – 11/2009, ku në periudhat 06/2009 – 09/2009 lexuesi I KEK-u nuk ka evidentuar se njehsori elektrik nr. 30662159 është i dëmtuar apo që mungon vula distributive e KEK-ut, por në periudhat 10/2009 dhe 11/2009 nuk ka shpenzim të regjistruar të energjisë elektrike të evidentuar, përkatësisht është përshkruar gjendja e njëjtë me periudhën 09/2009.

Bordi i ZRRE-së me rastin e shqyrtimit të ankesës së konsumatorit ka bërë edhe analizën e përgjithshme të rrjedhës së energjisë elektrike të kësaj pike matëse dhe nga kjo është konstatuar se konsumatori ka ndryshim të vogël në shpenzimin e energjisë elektrike që i përket periudhës 07/2007 deri më 02/2010 ku shpenzimi mesatar mujor ka qenë **727 kWh/muaj** (pa e llogaritur konstanten e TMRR- Transformatorëve matës Rrymor), ndërsa nga periudha 02/2010 deri më 08/2011 shpenzimi mesatar mujor i energjisë elektrike për këtë pikë matëse është **628 kWh/muaj** (pa e llogaritur konstanten e TMRR- Transformatorëve matës Rrymor), e që shprehur në përqindje ka një rënie prej **29%** të shpenzimit të energjisë elektrike. ZRRE me rastin e vendosjes së kësaj çështje ka marrë për bazë edhe këtë indikator nga e cila është dëshmuar se rrjedha e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhat e lartcekur ka qenë pothuajse konstante e pandryshueshme dhe nuk ka dhënë asnjë indikator të mundshëm se konsumatori ka keqpërdorur në këtë pikë matëse ashtu siç ka pretenduar KEK me rastin e vendosjes së kësaj çështje.

Për më tepër duhet të theksuar se konsumatori N.P. "M. M" ka ofruar kontratën e lidhur me datë 04.05.2009 mes tij dhe kompanisë ndërtuese "N. V.", për ndërtimin e objektit me sipërfaqe prej 4,000 m² si dhe janë pajtuar që objekti të përfundojë në muajin gusht 2009, si dhe ka ofruar edhe faturën nr. 005131 të datës 28.09.2009 për blerjen e dy gjeneratorëve, njëri me fuqi 100 KVA dhe tjetri me fuqi 150 KVA. Po ashtu duhet theksuar se konsumatori ka ofruar edhe kërkesën në KEK për rritje të fuqisë me datë 09.12.2009, si dhe faturën e blerjes së TMRR-ve me datë 15.12.2009 nga ndërmarrja tregtare private "EL-3".

Bordi i ZRRE-së konstatoi se vendimi i komisionit të parë i KEK-ut me të cilën me datë 19.02.2010 ka vendosur ta ngarkoj konsumatorin me shifër DPR – 90034109 me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike prej 08.12.2009 deri më 05.02.2010 është vendim i drejtë dhe i kalkuluar saktë, pasi që punëtorët e autorizuar të KEK me rastin e inspektimit të datës 08.12.2009 kanë konstatuar se konsumatori është i shkyçur nga rrjeti elektrik, ndërsa me datë 05.02.2010 gjatë inspektimit të pikës matëse të konsumatorit punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë hasur në njehsori elektrik i cili është i pavulusur, dhe i paregjistruar, andaj edhe për këtë periudhë konsumatori duhet të ngarkohet me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 03.10.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.



Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, u.d kryesues

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit A.K., (M. M),
- Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative,
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.